

Datë: 03.10.2025

Numër Protokolli: 6555/2025

A.nr.1322/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1322/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesja E.H, nga Kamenica, kundër Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1322/2025 e datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesja E.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil A,G (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 06.07.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 08.07.2025 nën shenjën A.nr.1332/2025, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017330, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Gjilan, i shpallur nga Inspektoratit të Punës, për shkak të shkeljeve ligjore përkatësisht mungesës së një arsytimi të detajuar në lidhje me vendimin përfundimtar të këtij procesi të regrutimit që ndërlidhet me ankuesen.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa ky i fundit, nuk ka përcjellë provat e kërkuara.

Kryetari i Këshillit, me datë 21.08.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 5667/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1322/2025 të datës 09.07.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të *përfundoj procedimi administrativ* i filluara me ankesën e ankueses, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017330, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin Gjilan, numri i kërkuar tre (3), klasa profesional 1.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, dhe sipas njoftimit për fazën e verifikimit paraprak e njëjta rezulton se ka kaluar fazën e verifikimit paraprak për të marr pjesë në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa pas përfundimit të procesit, rezulton se lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017330, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës më datë 05.07.2025 e ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me nëntë (9) kandidatë, që kanë marr mbi 70 pikë, ku rezulton se ankuesja nuk ka arritur të marr 70 pikë, respektivisht nuk rezulton të jetë kandidate e suksesshme.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër kësaj procedure të regrutimit, pretendon se ka shkelje ligjore përkatësisht mungesës të një arsyeimi të detajuar në lidhje me vendimin përfundimtar të këtij procesi të regrutimit që ndërlidhet me ankuesen, duke kërkuar që ankesa të shqyrtohet me seriozitet.

Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë numrin e lëndëve në shqyrtim, ka konstatuar se për të njëjtin konkurs lidhur me kontestimin e procedurave të rekrutimit, me datë 04.08.2025 Këshilli ka pranuar ankesë, ndërsa me datë 01.10.2025 Këshilli ka nxjerrë Vendimin A.nr.1530/2025 përmes së cilit është aprovuar ankesa e ankueses A.Sh.D, ndërsa është **anuluar** në tersi konkursi me Nr.Reference:RN00017330,Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjilanit, procedurë të rekrutimit të cilën e konteston edhe ankuesja në këtë çështje administrative.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1322/2025 të datës 09.07.2025 pasi që objekti i shqyrtimit të kësaj lëndës është bërë i pamundur apo i kotë, ngase përmes Vendimit A.nr.1530/2025 të datës 01.10.2025, Këshilli ka vendosur lidhur me këtë procedurë të rekrutimit sipas konkursit më shifër reference: RN00017330, Grupi Administrim i

Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Gjilan , me që rast ka anuluar të njëjtin.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nën 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr1322/2025, datë 03/10/2025

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses E.H;
- Inspektoratit të Punës (*Njësisë së Burimeve Njerëzore*), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 27.10.2025

Numër Protokolli: 7006/2025

A.nr.1322/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari - anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1322/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesja E.H, nga Kamenica, kundër Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, bazuar në nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Korrigjohet Vendimi A.nr.1322/2025 i datës 03.10.2025 ,me të cilin është vendosur për ankesën A.nr.1322/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesja E.H.

II.Korrigjimi i këtij vendimi bëhet në hyrje të arsytimit të këtij vendimi ,nga se është bërë lëshim teknik, pra në vend të fjalisë Kandidati për pranim në shërbimin civil A.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 08.07.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 08.07.2025,nën shenjën 1332/2025 ndërsa duhet të jetë: **Kandidatja për pranim në shërbimin civil E.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja)**, më datë 08.07.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 09.07.2025,nën shenjën 1322 ndërsa poashtu edhe kodi i sigurisë në vend të numrit 1332 duhet të jetë 1322.

III. Ky vendim korrigjues është pjesë përbërëse e vendimit A.nr.1322/2025 të datës 03.10.2025.

A r s y e t i m

Kolegji i Këshillit në ndërkohë ndërlidhur me këtë vendim ka vërejtur këtë lëshim teknik në hyrje të Arsytimit të vendimit A.nr.1322/2025 të datës 03.10.2025 andaj edhe mbi këtë bazë është bërë korrigjimi i të njëjtit. Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda,A.nr.1322/2025,datë 27/10/2025.**

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses E.H;
- Inspektoratit të Punës (Njesisë së Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.